



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I _____

SKEDA PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR”

(VKM Nr.112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM Nr. 808 date 11.12.2019 dhe VKM Nr.128 date 06.03.2024)

I. Të dhëna për personelin akademik:

Me kohë të plotë ☐

Me kohë të pjesshme ☐

Emri, atësia, mbiemri	
Universiteti, Fakulteti <i>(ku është paraqitur Dosja)</i>	
Departamenti ku është paraqitur dosja <i>(ku është paraqitur Dosja)</i>	
Fusha e studimit	
Vendi aktual i punës	
Grada shkencore	
Titulli Akademik qw zotëron	
Titulli i kwrkuar	

II. Skeda e veprimtarisw

Aktiviteti dhe standardet	Referenca rregullatore	Kërkesat për fitimin e titullit “Profesor ”	Dokumentet që paraqiten	Kriteri	Realizimi
1. Kategoria	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 2.	Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor i Asociuar”, aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor i Asociuar”.	Dokumenti që vërteton se aplikanti zotëron titullin “Profesor i Asociuar” prej të paktën 5 vjetësh.	5	
2. Roli i titullarit të lëndës /modulit dhe udhëheqësit shkencor	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 3. a.	Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor”, duhet: a. të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;	Dokumenti që vërteton angazhimin si titullar lënde/moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore.	5	
3. Lektrimi, përvoja në rolet akademike, udhëheqje doktoratash, zotërimi i gjuhëve	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. b.	Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor”, duhet: b.1 të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, b.2 ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë)-vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”. Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë: 1.5 (një pikë pesë) vite kohë e pjesshme konvertohet me 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor".	Vërtetimi zyrtar nga departamenti i përvojës minimale 8-vjeçare si personel akademik me kohë të plotë, lektor, me ose pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme për 12 vjet pas fitimit të gradës “Doktor	8 12	
	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. c.	Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor”, duhet si rregull, të ketë udhëhequr ose bashkeudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Nw rast bashkwudhwheqje kjo e fundit duhet të jetë me personel akademik të kategorisë “Profesor”, me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. Në	Vërtetimi i udhëheqjes të paktën i 2 doktoratave të përfunduara. Dokument që vërteton se kandidati ka udhëhequr 1 doktoratë, në një	2	

		rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit. Për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027, për titullin akademik “Profesor”, kriteri i shkronjës “c”, të pikës 3, të Kreut III, të VKM-së 112, e ndryshuar konsiderohet i plotësuar nëse ka udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar. Ndërsa, në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, kriteri i shkronjës “c”, të pikës 3, të Kreut III, të VKM-së 112, e ndryshuar, konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është duke udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë si dhe të përmbushë një nga kushtet e mëposhtme: - Të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar; - Të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht apo italisht; - Të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të	institucion me deri 40 punonjës akademikë	1	
--	--	--	---	---	--

		doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkudhëheqje të doktoratës.			
	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. ç.	Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor”, duhet të jetë i aftë të: a. mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose b. mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara jurisë, të ngritur me vendim të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT-së.	Dokumentimi i zotërimit të gjuhës së huaj (angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle) ose të mbrojtjeve veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Jurisë në një nga këto gjuhë.		
4. Zotërim të plotë i fushës së tij kërkimore: botimet & referimet	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 4. a. Rregullore e KPPA e UT-së, Kreu III, Neni 16, Seksioni II, pika 2a.	Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon: Ka botuar së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej këtyre artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (ICR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). Kur këta artikuj janë në bashkëautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në të paktën katër artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.	Dokumentimi i të paktën 7 artikujve shkencorë të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (ICR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).	7	3

			Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit	4	
	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 4. b.	Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon: Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) referime janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 5 referime (së paku); Dokumentimi i 2 referimeve në aktivitetin (simpozium, konferencë, kongres) në vende të BE, OECD, G20; Dokumentimi i vlerësimit paraprak dhe i botimit në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	5 2	
5. Monografite dhe ekuivalentimi	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 5. a. Rregullore e KPPA e UT-së, Kreu III, Neni 19, pika 2.	Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5, të këtij Kreu, sipas ekuivalentimit që vijon: a. Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të titullit “Profesor i Asociuar”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga <i>SENSE Ranking of Academic Publishers</i>, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të	Dokumentimi i 1 (një) monografie të botuar pas mbrojtjes së gradës “Doktor i shkencave”, e cila të jetë origjinale, e vlerësuar nga dy vlerësues të pavarur, të pranuar nga njësi bazë. Vërtetimi se monografia e botuar jashtë është e rankuar në SENSE RAP, A/B/C/D.		

		ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës. b. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me: i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit; ose ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). c. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me: i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit; ose ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).	Dokumentimi për njohjen e një monografie të dytë, që tregon ndryshimin në përmbajtje me të paktën 70% nga një monografi e mëparshme. Vërtetimi se monografia e botuar brenda vendit është e vlerësuar nga 2 profesorë, njëri nga vendet e BE, OECD, G20. Ekuivalentimi i monografisë/ve të dokumentohet dhe të argumentohet përmes vlerësimit të qartë nga departamenti me argumentet shkencore dhe mbështetjen ligjore në të cilin mbështetet ky ekuivalentim.		
6. Angazhimi dhe aktiviteti i aplikantit, pas fitimit të titullit	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 6, a-ë. Manuali “Mbi ekuivalentimin e	Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”, në: a. komitete shkencore apo redaktuese;	Vërtetimi i anëtarësisë në komitete shkencore apo redaktuese; Vërtetimi i pjesëmarrjes në veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor		

“Profesor i asociuar”	veprimtarive akademiko – didaktike të kandidatëve në kërkim të fitimit të titullit akademik”, Seksioni II.	b. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë; c. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar; d. përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar; e. projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit; f. vlerësim projektësh kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare si vlerësues; g. drejtimin e komiteteve organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare si drejtues i komitetit; h. projektet e transferimit teknologjik të patentave.	apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë; Vërtetimi i pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar; Vërtetimi i përfitimit të financimeve me konkurrim në nivel kombëtar e ndërkombëtar; Vërtetimi i angazhimit në rolin e koordinatorit të projektit të financuar nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin; Vërtetimi i qenies vlerësues për projekte kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare; Vërtetimi i angazhimit si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare; Vërtetimi i pjesëmarrjes në projektet e transferimit teknologjik të patentave.		
7. Ekuivalentimi nga KPPA-ja i angazhimit	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018,	Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në së paku 4 veprimtari të përcaktuara në pikën 6, Kreu III, të VKM Nr. 112, mund të ekuivalentohet, bazuar në manualin e KPPA-së, me:	Raporti i njësisë bazë, që konfirmon angazhimin në veprimtaritë e parashikuara në pikën 6 Kreu III të VKM		

dhe i pjesëmarrjes së aplikantit në veprimtaritë e pikës 6	Kreu III, 7, a dhe b. Manuali “Mbi ekuivalentimin e veprimtarive akademiko – didaktike të kandidatëve në kërkim të fitimit të titullit akademik”, Seksioni II. VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 8	a. 1 (një) artikull shkencor, i botuar në revistë shkencore ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) ose b. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të Nenit 17 të kësaj rregulloreje dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	Nr. 112 dhe në zbatim të kushtëzimeve të Rregullores dhe Manualit të KPPA-së.. Vlerësim i veçantë dhe i qartë hartohet nga njësia bazë e njësisë kryesore mbi të shprehet Juria dhe pranohet ose jo nga <i>Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik</i> në pajtim me përcaktimet në Rregulloren dhe Manualin e KPPA-së.		
8. Vlefshmëria e aktivitetit	VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 9.	Për fitimin e titullit akademik “Profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “Profesor i Asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor” pranë drejtuesit të njësisë kryesore.	Dokumentimi i aktivitetit shkencor si të vlefshëm brenda 2 datave limit.		

TABELË E DOKUMENTIMIT TË ARTIKUJVE SHKENCORË TË PUBLIKUARA (PAS DOKTORATURËS)

Nr.	Titulli i artikullit	Autor i Parë	Autorët e tjerë sipas rënditjes origjinale	Emërtimi i Revistës		Referenca për Revistën			Viti i Botimit, faqet	Lloji i Faktorit të impaktit me shifer dhe Link	Linku ku gjendet artikulli
				Brenda vendit	Jashte vendit	Botuesi	ISSN	Indeksimi (IF)			
1											
2											
3											
4											
5											
6											

**TABELË E DOKUMENTIMIT TË PJESMARRJES NË SIMPOZIUME, KONFERNCA DHE
KONGRESE SHKENOCRE ME PROCEEDINGS (PAS DOKTORATURËS)**

Nr.	Titulli i materialit të paraqitur	Autor i parë	Autorët e tjerë sipas renditjes origjinale	Emërtimi i aktivitetit shkencor ku është prezantuar			Referenca për aktivitetin	Viti i aktivitetit/botimit, faqet	Linku ku gjendet proceedings dhe a ka bord editorial
				Brenda vendit	Jashtë vendit	Organizuesi/Botuesi	ISSN ISBN		
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									

TABELË E DOKUMENTIMIT TË UDHËHEQJES SË DOKTORANTËVE

Nr	Emri i kandidatit që ka udhëhequr	Viti i përfundimit të doktoraturës së kandidatit	Titulli i punimit të mbrojtur nga kandidati

***Nëse kandidati ka realizuar studime post doktoratë apo aktivitete të tjera në interes të fitimit të titullit për të cilin aplikon mund të shtohen.**

Emër mbiemër i kandidatit

Relatorët e njësisë bazë

Drejtuesi i njësisë bazë
